

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Atentati në Sarandë ndodhi 67 metra larg komisariatit, policia arriti pas 10 minutash
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392938.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 13:29:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	20 shtator 2026, 13:20:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 20 shtator 2026, 13:19:00 UTC → 20 shtator 2026, 13:21:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0ef58d22e8e861ab59a30aca168a968e04b606669662236fa825504fec5f37b6
TEKSTI	a01451f8ddf0c3a180c87fff960a9864aae34c8b22dd92bb898b67d838374965
PAMJA	3b695504d8b9bfa4412dfab747a83e14ba3daf3d7e77684ab31dfdaaf1a54860

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9d96288430948e5906a6cf2850e124cde66831d23fe3092ad01fba13b56781e7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9767af9aea99dbf2ca0400fc3d10892444ae0e1100c3c88a0d864d11255bea91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9d96288430948e5906a6cf2850e124cde66831d23fe3092ad01fba13b56781e7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Atentati në Sarandë ndodhi 67 metra larg komisarariatit, policia arriti pas 10 minutash

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 20.09.2026, 15:20



Share



Share



Policia e Sarandës të dielën e ka pushim? Kjo është një nga pyetjet që mbetet pezull pas ekzekutimit të 44-vjeçarit Artan Myrtaj në qendër të qytetit.

Një video me dron e mbërritur në redaksinë e JOQ Albania tregon qartë distancën mes komisarariatit të Sarandës dhe vendit ku ndodhi atentati. Janë vetëm 67 metra që ndajnë institucionin e policisë nga vendi ku u qëllua për vdekje 44-vjeçari. Megjithatë, sipas të dhënave të bëra publike për ngjarjen, forcat e policisë kanë mbërritur rreth 10 minuta më vonë.

Një distancë që në kushte normale mund të përshkohet në pak sekonda me makinë, aq më tepër nga një mjet policie me sinjale, por që në këtë rast nuk u përkthye në një reagim të menjëhershëm.

Dhe ndërsa autorët kishin nevojë vetëm për pak çaste për të kryer atentatin dhe për t'u larguar, policia ndodhej vetëm disa metra larg. Megjithatë, kur forcat mbërritën në vendngjarje, autorët ishin zhdukur.

Myrtaj, i njohur në qytet si "Tani i Ruzhdiut", sapo kishte konsumuar një kafe në një lokal pranë kryqëzimit të ish-agjencia, një zonë e populluar e Sarandës. Ai ishte ftuar nga një mik, por qëndroi vetëm pak minuta.

Teksa po largohej qetësisht, një motor me dy persona të veshur me skafandra iu afrua. Ata qëlluan në drejtim të 44-vjeçarit, por fillimisht nuk mundën ta godisnin. Myrtaj tentoi të largohej, por vetëm pak metra më tutje u përball sërish me breshërinë e plumbave, e cila rezultoi fatale.

Artan Myrtaj humbi jetën në vend.

Pas ngjarjes, policia deklaroi se grupi hetimor kishte ngritur pika kontrolli në drejtim të Gjirokastrës dhe Vlorës, në përpjekje për të identifikuar dhe kapur autorët.

Por pyetja që mbetet është shumë më pranë vendit të krimit: Si është e mundur që një atentat të ndodhë vetëm 67 metra larg komisarariatit të policisë dhe autorët të kenë kohë të kryejnë krimin e të largohen, ndërsa forcat e policisë mbërrijnë rreth 10 minuta më pas?

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat



Albanian Media
Ethics
Alliance

ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.